

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Analiza ekonomike e së drejtës
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti IV, Semestri V
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Salla nr. 3
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Mejdi Bektashi
Detajet kontaktuese:	mejdi.bektashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<i>Studimi i lëndës “Analiza ekonomike e së drejtës” është një hyrje e përgjithshme mbi njohuritë dhe metodat e shtjellimit të shkencës ekonomike. Të kuptojnë se e drejta ka ndikim të veçantë dhe të fuqishëm, por nga ana tjetër dhe parashikues në karakterin e jetës dhe aktiviteteve ekonomike dhe se nga ana tjetër se e drejta zhvillohet dhe modifikohet si përgjegjje ndaj ndryshimeve ekonomike.</i>
Qëllimet e lëndës:	<i>Qëllimi i studimit të kësaj disipline ekonomiko - juridike, dhe shumë aktuale është që studentëve të studimeve pasdiplomike – master, t’iu ofrojë njohuri thelbësore e të mjaftueshme por njëkohësisht dhe aktuale lidhur me proceset më aktuale në fushën e ndërlikohjes së drejtësisë dhe ekonomisë.</i>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<i>Aftësitë dhe shkathtësitë që do t’i fitojnë studentët pas përfundimit të sukseshëm të kësaj lënde, është që:</i> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Të kuptojnë se jo stabiliteti ligjor kushtëzon shkallën e caktuar të jostabilitetit të tërë sistemit shoqëror e në veçanti të aktiviteteve ekonomike;</i> • <i>Të kuptojnë dhe të dinë të shpjegojnë se ligjet kushtëzojnë limitimin e lirisë së zgjedhjes për çdo individ dhe se sistemi i denimeve dhe shpërblimeve në kuadër të punës shtetërore i jep marrësve dhe zbatuesve të denimeve stimuluese të dobëta për të kërkuar zgjedhje më efikase dhe pse ndodhë e kundërta kur kemi të bëjmë me pronën private;</i> • <i>Të kuptojnë se institucionet vëjnë rregull në jetën ekonomike dhe se në mënyrë dominuese ndikojnë në funksionimin e sistemeve të ndryshme ekonomike;</i>

	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojnë se tregu nuk mund të funksionojnë në mënyrë efikase pa definimin e qartë të të drejtave pronësore; • Të kuptojnë se vendimi për të kryer një krim është një funksion i kostove dhe dobive (përfitimeve) të këtij krimi. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	1.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	1	1
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			142.5 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>Me ndihmën e ligjeratave, prezentimeve, seminarëve, punës në grupe, testëve dhe formave tjera të mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive gjatë gjithë semestrit, studentët aftësohen që në të ardhmën, në mënyrë të pavarur dhe në cilësinë e ekspertit profesional t'i sfidojnë sfidat që paraqiten edhe në fushën e marrjes së vendimeve ekonomike, financiare dhe ato juridike.</i></p>		
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata, dhe debate: 10% • Pjesëmarrja në prezentime: 10% • Punimi seminarik me shkrim dhe i mbrojtur: 20% • Provimi përfundimtarë: 60% • Gjithsejt: 100% 		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjerata të autorizuara të mësimdhënësit. 2. Richard Posner: <i>Economic Analysis of Law</i>, Little, Brown and Company, London 1992. 		

	3. <i>Steven Shavell: Foundations of Economic Analysis of Law, Harvard University Press, 2009.</i>
Literatura shtesë:	1. <i>Todd G. Buchholz: Ide të gjalla nga ekonomistë të vdekur, ISP & Dita 2000, Tiranë, 2009.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Ekonomia dhe drejtësia; Analiza ekonomike e krimin; e drejta e detyrimeve; Ligji antitrust; Kriminaliteti dhe racionaliteti njerëzor në vepër.
Java e dytë:	Ekonomia institucionale; Teorema e Ronald Coase; E drejta e vjetër dhe ekonomiksi; E drejta e re dhe ekonomiksi; Institucionet, e drejta dhe ekonomiksi.
Java e tretë:	Nocionet fundamentale ekonomike dhe principet e rëndësishme për analizën ekonomike të së drejtës; nocioni i resurseve dhe kufizimi i tyre ; Ekonomia është shkencë mbi zgjedhjen racionale; oferta dhe kërkesa si instrumente të analizës ekonomike;
Java e katërt:	Ekonomia neoklasike dhe neoinstitucionale, dallimet dhe ndërlidhshmëria; Prona në të drejtën dhe ekonomaksin;
Java e pestë:	Prona private – apo e drejta pronësore e pa zvogëluar; Kufizimi i pronës private; Pronësia kolektive; Kufizimi i pronës kolektive; Pronësia shtetërore.
Java e gjashtë:	Shpenzimet transakcionale; Matja e shpenzimeve transakcionale; Llojet e shpenzimeve transakcionale, rëndësia e tyre.
Java e shtatë:	Firma (ndërmarrja); Firma si funksion prodhues; Teoria e marrëveshjes (kontratës) së firmës.
Java e tetë:	E drejta ekonomike si standard kontraktues; Kontratat, ligjet dhe ndërmarrjet; Llojet e ndërmarrjeve sipas pronësisë; Format organizative të ndërmarrjeve; Korporatat.
Java e nëntë:	Karakteristikat ligjore të korporatës – efektet ekonomike; Efektet ekonomike të përgjegjësisë së kufizuar, morali hazard; Depërtimi ose modifikimi i përgjegjësisë së kufizuar; Detyrimi i sjelljes së caktuar të ndërmarrjes.
Java e dhjetë:	Financimi i korporatave; Përgjegjësia e kufizuar dhe shpenzimet e financimit të kapitalit; Klauzula e interesave konfliktuale.
Java e njëmbëdhjetë:	Institucionalistët e rinj dhe ekonomiksi i ligjit; Neglizhenca; Pronësia; Krimi; Financimi i Korporatave (T.B. 276-292)
Java e dymbëdhjetë:	Shkolla e zgjedhjes publike: politika si biznes; Paradoksi i grupeve të veçanta të interesit; Ciklet politike (T.B. 354-378)
Java e trembëdhjetë:	Pronësia, definimi dhe krijimi i të drejtave pronësore; ndarja e të drejtave pronësore; Fitimi dhe bartja e të drejtave pronësore; Pronësia intelektuale (S SH. 9-33, 137-150)
Java e katërmëdhjetë:	Zbatimi i ligjit dhe e drejta penale; prevencioni me sanksione monetare; prevencioni me sanksione jomonetare.

Java e pesëmbëdhjetë:

Përgaditja për provim final.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- *Vonesa në ligjerata dhe ushtrime;*
- *Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme);*
- *Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimit;*
- *Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale.*

Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:

- *Kopjimi gjatë provimit ose testit;*
- *Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;*
- *Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;*
- *Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.*